



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 160/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndriçim Rrugor, (Rikonstruksion)”, me nr. REF-88979-03-03-2021, me fond limit 58,326,574 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec.

Anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Mag-Utilities” SHPK
Adresa: Rezidenca “Kodra e Diellit 2”, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Bashkia Pogradec
Adresa: Lagjja nr. 2, Blv. “Reshit Çollaku”, Pogradec.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.03.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Ndriçim Rrugor, (Rikonstruksion)*”, me nr. REF-88979-03-03-2021, me fond limit 58,326,574 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.04.2021, nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 10.03.2021, operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilities” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit, si dhe anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...]Në kërkesat për kualifikim keni kërkuar xhiron e viteve 2017, 2018 dhe 2019, ndërkohë që tre vitet e fundit financiare, ashtu sikurse parashikohet në ligj, janë vitet 2018, 2019, 2020.

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, keni kërkuar bilancet, të cilat janë me shumë se tre vitet e fundit, pasi nuk mund të kërkonti bilancin e vitit 2017, si dhe të mos kërkonti bilancin e vitit 2020.

Lidhur me pagesën e taksave vendore, nuk keni kërkuar vërtetimin që merret për shlyerjen e tyre, por një deklaratë nga shoqëria, e cila nuk provon shlyerjen e taksave vendore.

Lidhur me shërbimet e ngjashme, keni kërkuar kërkesat e DST për punë publike, ndërkohë që ju e keni procedurën e prokurimit blerje malli. Në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore nuk ka të parashikuar për rastin e blerjes së mallit, që ky kriter plotësohet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe në BOE, në kundërshtim kjo me nenin 74 të VKM. Gjithashtu, në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik keni kërkuar formular vlerësimi, i cili kërkohet vetëm në DST për punë publike, si dhe kontratën, të cilat janë kërkesa antiligjore.

Keni kërkuar kategorinë e licencës NP 11, ndërkohë që kjo kategori është vetëm për punime ndërtimore, dhe jo për blerje malli.

Nuk ju përputhet numri i mjeteve të kërkuara, me numrin e manovratorëve të kërkuar.

Keni kërkuar licencë për auditim energjie në ndërtesa, ndërkohë që ju po zhvilloni një procedurë prokurimi blerje malli.

Nuk keni specifikuar se kush quhet ngjyrë e ndezuar, meqenëse i kërkonti katalogët me këtë ngjyrë.

Në DST keni kërkuar deklaratë për mirëmbajtje 3 vjeçare, ndërkohë që procedura e prokurimit që ju po zhvilloni është blerje malli.

Keni kërkuar nga 2 mostra për secilin tip ndriçuesi dhe nuk e kuptojmë, përse duhen dy dhe jo një. Ju lutem na sqaroni se ku mund ti gjejmë zarfet që të mbyllim mostrat e ndriçimit.

Nuk keni asnjë mbështetje ligjore mbi kërkesën që do të bëni një javë vlerësimi në praktikë lidhur me përputhjen e modelit.

Kërkesa që ofertuesi duhet të ketë 35% të mallit në gjendje, është një kërkesë që nuk bazohet në asnjë legjislacion në fuqi, kufizon konkurrencën dhe vë në kushte jo të barabarta konkurrimin e operatorëve ekonomikë të ndryshëm. Shpallja e fituesit nuk është bërë dhe kontrata nuk është lidhur ndaj nuk ka edhe arsye përse të jetë malli gjendje në magazinë. Për këtë arsye kërkujmë heqjen e këtij kriteri.

Ndërkohë në opinionin tonë kriteri i pikës 2.3.13 nuk është i bazuar në ligj dhe rrjedhimisht është antiligjor ndaj dhe kërkujmë heqjen e tij.

Në preventivin e publikuar, keni kërkuar edhe ofertë për mirëmbajtje trevjeçare, por keni harruar se po zhvilloni një procedurë prokurimi të hapur për blerje malli. Pra, i nderuar titullar, ju po anashkaloni një PPP, të cilat aktualisht janë të ndaluara me ligj, duke e publikuar si blerje malli, ndërkohë që nuk është e tillë.

Lidhur me specifikimet teknike kundërshtojmë si më poshtë:

1.AK kërkon nivel mbrojtje IP67 i cili është i vlefshëm për ndriçues që zhyten nën ujë. Niveli më i lartë i mbrojtjes për ndriçimin rrugor është IP66 ndaj duhet zëvendësuar IP67 me IP66

2. AK kërkohen këndin e hapjes së dritës prej 150°, ndërkohë që ky kënd për ndriçim rrugor duhet të jetë asimetrik që do të thotë që duhet të shprehet në dy dimensione p.sh. 150°x55°

3. Për çdo tipologji ndriçimi duhet të na përcaktoni mënyrën e kapjes në shtyllë dhe gjithashtu dhe diametrin e kapjes për çdo tipologji/model .

Sa ndriçues do të lidhen direkt në shtyllë dhe sa do të jetë dimensionin në pikën e lidhjes së ndriçuesit me shtyllën. Gjithashtu kush tip/model ndriçuesi do të lidhet direkt në shtyllë.

Sa ndriçues do të lidhen me krahë në shtyllë dhe sa do të jetë dimensionin në pikën e lidhjes së ndriçuesit me krahun e shtyllës. Gjithashtu kush tip/model ndriçues do të lidhet me krahun e shtyllës.

Është shumë e paqartë mënyra e montimit të ndriçuesit model 4.

4. Ndriçuesi model 5 nuk kuptohet nëse: vizatimi i skedës teknike është i ndriçuesit apo vetëm një pjesë e tij është ndriçues dhe pjesa tjetër është shtyllë. Ju lutem përcaktoni më qartë.

Gjithashtu nëse një pjesë e skicës së paraqitur në Skicën e Ndriçuesit model 5 nga ana juaj është shtyllë, përcaktoni edhe mënyrën e montimit të saj me tokën.

5. Në skicat e modeleve të vëna në dispozicion nga AK, përcaktohet fuqia në watt. Mirëpo sasia e ndriçimit të nevojshëm dhe të kërkuar përcaktohet në Lm dhe jo në watt dhe ky kriter pengon OE që të bëjnë një ofertë e cila mund të ofronte të njëjtën sasi ndriçimi në Lm duke konsumuar me pak energji në watt, gjë e cila do të sillte një përfitim ekonomik AK.

Pra ne kërkojmë që ky kriter të hiqet pasi nuk lejon që të ofrohen ndriçues me efikasitet më të lartë që i sjellin edhe kursim AK. Duke mos e hequr këtë kriter AK bëhet shkas e një dëmi të mundshëm ekonomik ndaj institucionit pasi pengon mundësinë e ofertimit të ndriçuesve me efikasitet më të lartë.

6. AK kërkon dimensione fikse të ndriçuesve, gjë e cila është kriter diskriminues dhe na shtyn të mendojmë që në këtë garë është paracaktuar fituesi. Çfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar nëse dimensionet do të ishin të përafërta dhe jo ekzakte, mos vallë nuk do të ndriçohej rruga?

Kriteret që përcaktojnë e ndriçimit të rrugës janë Lm dhe jo dimensionet e ndriçuesit, ndaj edhe ne kërkojmë që ky kriter të hiqet.

7. Në tabelën me përmasat e shtyllave nuk janë përcaktuar të gjitha dimensionet e shtyllës. Më saktësisht në shtyllën model 2 dhe model 3 nuk përcaktohet se në çfarë Ø duhet të jetë tubi i këtij modeli.

8. Tek tabela e modeleve në dokumentin me emërtim skica specifikime përfundimtare.doc, sasia e ndriçuesit model 3 është 315 copë, model 4 është 1915 copë, model 6 është 10 copë dhe sasitë e krahëve metalik model 2 dhe model 3 janë të përcaktuara më vete për secilin model, ndërkohë që në dokumentin me emërtim PREVENTIVI PËR NDRICIMIN PUBLIK. doc për ndriçuesin model 3 kërkoni 311 copë , modelin 4 kërkoni 1914 copë, modelin 6 kërkoni 15 copë dhe për shtyllat model 2 dhe model 3 kërkoni në total 500 copë por pa specifikuar sa prej secilit model

Në dokumentin me emërtim PREVENTIV PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc kërkoni F.V përcjellës i veshur 26,000 ml pa përcaktime teknike gjë që në opinionin tonë lë hapësira për interpretim dhe abuzim në kuotimet që do të bëhen nga çdo OE. Ju lutemi përcaktoni se çfarë duhet ekzaktësisht.

Në dokumentin me emërtim PREVENTIVI PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc kërkoni F.V. Sensorë drite dhe çelësa fundore 2,500 copë pa dhënë specifikime teknike për secilin dhe pa përcaktuar sasinë për secilën gjë që në opinionin tonë lë hapësira për interpretim dhe abuzim në kuotimet që do të bëhen nga çdo OE. Ju lutemi përcaktoni se çfarë duhet ekzaktësisht.

9. Në dokumentin me emërtim skica specifikime përfundimtare.doc, tabelat e shpërndarjes së ndriçuesve sipas rrugëve nuk janë të lexueshme.

10. Në dokumentin me emërtim skica specifikime përfundimtare.doc, në faqet 76-79 janë disa tabela që kanë sasi dhe fuqitë e ndriçuesve ekzistues dhe atyre që do të vendosen.

Ne dëshirojmë të dimë nëse duhet ti referohemi këtij dokumenti për të bërë ofertën tonë apo dokumentit me emërtim PREVENTIVI PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc.

Sa më sipër, mospërcaktimi i këtyre të dhënave, shkakton konfuzion në dhënien e ofertës, si dhe nuk i vendos ofertuesit në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi. Në kushtet e mësipërme, kërkojmë anulimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit, pasi keni zbatuar DST të ndryshme për sa kërkoni në kërkesat për kualifikim, ose vendosjen e tyre sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, [...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimes “Mag Utilities” SHPK, me anë të shkresës nr.1171/3prot., datë 18.03.2021, duke mos e pranuar atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“[...]Në këtë ankesë ,operatori ekonomik “Mag - Utilities” SHPK, pretendon:

1-Në lidhje me kriteret ekonomike “Në kërkesat për kualifikim keni kërkuar xhiron e viteve 2017, 2018 dhe 2019, ndërkohë që tre vitet e fundit financiare, ashtu sikurse parashikohet në ligj janë vitet 2018, 2019, 2020. Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, keni kërkuar bilancet, të cilat janë më shumë se tre vitet e fundit, pasi nuk mund të kërkoni bilancin e vitit 2017, si dhe të mos kërkoni bilancin e vitit 2020.”

Për këtë kriter, KSHA vëren se:

Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron duke arsyetuar si më poshtë:

Duke qenë se prokurimi ka si afat të fundit për dorëzimin e ofertës datën 05/04/2021, ndërkohë që detyrimi i tatimpaguesve në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28/12/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” nenet 29 dhe 50, për dorëzimin e bilancit kontabël ku rezulton dhe xhiro vjetore është data 31 mars, atëherë është pothuaj e pamundur që brenda hapësirës prej 5 ditësh (në fakt 3 ditësh pasi ka 2 ditë pushim në datat 3 dhe 4) operatorët të mundin të sigurojnë vërtetimet për xhiron vjetore e cila rezulton nga bilancet e paraqitura nga tatimpaguesit, të cilat edhe duhet të verifikohen dhe certifikohen nga organet tatimore. Brenda 5 ditëve është e pamundur të përgatitet një vërtetim i tillë për xhiron e vitit 2020 dhe për këtë arsye Njësia ka pasqyruar në kërkesa vitet 2017-2018-2019 pa përfshirë vitin 2020, pasi vendosja e këtij kriteri do të çonte në

pamundësi për të plotësuar këtë kriter duke mos siguruar konkurrencë nga shumë operatore. Vitet 2017-2018-2020 janë vitet e fundit mbi të cilat operatorët mundet të plotësojnë kriterin dhe bilanci dhe vërtetimi “mbi xhiron për këto vite është i mundur dhe jo mbi vitin 2020.

2-Në lidhje me pretendimin e dytë të operatorit ekonomik “Mag - Utilities” SHPK Operatori pretendon se: Lidhur me pagesën e taksave vendore, nuk keni kërkuar vërtetimin që merret për shlyerjen e tyre, por një deklaratë nga shoqëria, e cila nuk provon shlyerjen e taksave vendore”. Për këtë kriter KSHA vëren se: Njësia në këtë përcaktim ka pasur parasysht mosngarkesën e operatorëve me dokumentacion në rastin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore, pasi është kërkuar vetëm një vit (viti 2020) dhe pajisja me vërtetim për kryerjen e pagesës për vitin 2020 përsëri do ishte i pamundur pasi në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përcaktohet në nenin 5, pika c, se afatet dhe kështet për pagesën e taksave vendore për tatimpaguesit është në kompetencë të Këshillave Bashkiakë të çdo Bashkie, duke e bërë të ndryshme përcaktimin e pagesës së taksave dhe tarifave vendore (si ka raste kur një tatimpagues mundet të mos ketë paguar taksat dhe tarifatat për kështin e fundit 2020 por nuk është në vonesë pasi Këshilli i Bashkisë ka përcaktuar se kjo pagesë mund të kryhet deri në fund të 3 mujorit pasardhës). Për këtë qëllim është kërkuar vetëdeklarimi si i mjaftueshëm dhe verifikimi nga ana e AK-së në këtë rast është shumë i thjeshtë. Në çdo rast paraqitja e deklaramit të rremë në këtë rast do të përbënte shkelje administrative dhe rrjedhimisht skualifikim nga procedura dhe përjashtim nga prokurimi publik, ashtu si është përcaktuar në ligj dhe në paragrafin e fundit të kritereve për kualifikim pjesë e DST-së.

3-Operatori ekonomik “Mag - Utilities” SHPK ankohet për kriteret e veçanta për kualifikim në DST. Konkretisht, “Lidhur me shërbimet e ngjashme, keni kërkuar kërkesat e DST për punë publike, ndërkohë që ju e keni procedurën e prokurimit blerje malli. Në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore nuk ka të parashikuar për rastin e blerjes së mallit që ky kriter plotësohet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe në BOE, në kundërshtim kjo me nenin 74 të VKM. Gjithashtu, në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik keni kërkuar formular vlerësimi, i cili kërkohet vetëm në DST për punë publike, si dhe kontratën, të cilat janë kërkesa antiligjore. Keni kërkuar kategorinë e licencës NP 11, ndërkohë që kjo kategori është vetëm për punime ndërtimore, dhe jo për blerje malli. Keni kërkuar licencë për auditim energjie në ndërtesa, ndërkohë që ju po zhvillonit një procedurë prokurimi blerje malli. Në DST keni kërkuar deklaratë për mirëmbajtje 3 vjeçare, ndërkohë që procedura e prokurimit që ju po zhvillonit është blerje malli”.

KSHA-ja argumenton se: Duke qenë se argumentimi i operatorit për gjithë kërkesë/ankesat është i njëjtë po i sqarojmë njëherazi. Kjo procedurë prokurimi parashikon në gjithë elementët e mallrave që do furnizohen edhe vendosjen e mallrave në funksionim (FV sipas preventivit), mirëmbajtjen e tyre (mirëmbajtja është element që siguron autoritetin kontraktor për funksionimin e reduktimit të energjisë çka është qëllimi kryesor i këtij projekti). Në këtë rast kjo kontratë publike, ka të përfshirë edhe furnizimin me mallra (si kontratë furnizimi) edhe vendosjen e mallrave në funksionim (si kontratë e punëve publike). Për këtë qëllim, ashtu si është kërkuar dhe interpretuar për të disatën herë nga organet e auditit dhe nga vetë APP-ja (e cila jo pa qëllim vendos në faqen e parë të çdo seti dokumentesh standarde të tenderëve cilësimin se çdo mosparashikim konkret i këtij seti dokumentesh autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi), në rastin e

kontratave të përziera do përdoret procedura dhe dokumentet e tenderit të atij prokurimi i cili ka dhe vlerën më të madhe në kontratë. Pra në këtë rast, zëri i materialeve ka peshën kryesore të gjithë kontratës (rreth 80-85%). Ky fakt nuk do të thotë të mos përdorësh kërkesa dhe formularë të kontratës së punëve publike, pavarësisht se është vlerë më e vogël. Në këtë kuptim, nëse nuk do vendosnim kritere dhe kërkesa edhe për kontratat e punëve publike (sigurisht në masën e përshtatshme në raport me vendin që zë puna publike respektive në këtë rast), atëherë Autoriteti Kontraktor do të shkelte dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht nenin 46 të L.P.P-së i cili kërkon nga Njësia e Prokurimit vendosjen e kritereve në përputhje me natyrën e objektit që do prokurohet. Nëse nga ana jonë nuk do kërkojmë kritere për vendosjen e mallrave në funksionim (si përvojë të ngjashme, aftësi teknike etj.) atëherë kush e siguron autoritetin kontraktor për suksesin e kontratës? Në rast të mosvendosjes së kriterit për kategorinë e licencës për vendosjen e ndriçuesit, ju duket ligjore që operatori të punojë me vendosjen e ndriçuesve pa pasur një licencë të tillë? Çdo operator ekonomik ka gjithë të drejtën të pretendojë që nuk mundet të vendosë mallrat në funksionim. Autoriteti kontraktor në këtë rast ka përdorur vetëm kërkesa të parashikuara nga LPP-ja dhe nga VKM nr. 914, datë 29.12.2014, sigurisht nga kriteret e parashikuara për punët publike në raport me sasinë e punëve publike që do realizohen nga kjo kontratë. Nga arsyetimi strikt ligjor, duke i shtuar argumentimit të nenit 46, të LPP-së edhe parashikimet e përcaktuara dhe miratuara tashmë në ligjin e ri, Nr. 162/2020, Për Prokurimin Publik, i cili pavarësisht se hyn në fuqi në datën 31 mars 2021, përsëri bën saktësimin dhe interpretimin e këtij rasti në nenin 5 të tij ku parashikon ekzaktësisht sa më sipër.

4-Në lidhje me pretendimin e katërt të operatorit ekonomik “Mag - Utilities” SHPK. Operatori pretendon se: “Nuk ju përputhet numri i mjeteve të kërkuara, me numrin e manovratorëve të kërkuar”

KSHA-ja argumenton: a. Në pikën 2.3.4 të DST-së, janë kërkuar midis të tjerave edhe 1 (një) manovrator, ndërsa në pikën 2.3.6, është kërkuar në cilësinë e mjeteve Autokullë me kosh 1 (Një) dhe Kamionçinë për transport 1 (Një) me arsyetimin e vetëm pasi qëllimi i kërkesës për manovratorin është për të drejtuar Autokullën me kosh, e cila është mjete kryesor që do punojë vazhdimisht në gjithë territorin e Bashkisë, madje është i nevojshme edhe për mirëmbajtjen. Manovratori për kamionçinën e transportit jo vetëm që do jetë jo gjatë gjithë kohës por është gjykuar e tepërt kërkesa e një shoferi në kërkesa, (përderisa është kërkuar kamionçina sigurisht që dikush do e drejtojë). Qëllimi ka qenë për mos ngarkuar operatorët me kërkesa të tepërta, çka në përgjithësi po e kërkon edhe ju.

5-Operatori ekonomik pretendon gjithashtu se : “Keni kërkuar nga 2 mostra për secilin tip ndriçuesi, dhe nuk kuptojmë përse duhen dy dhe jo një. Ju lutem na sqaroni se ku mund ti gjejmë zarfet që të mbyllim mostrat e ndriçimit.

Për pretendimin e mësipërm KSHA-ja arsyeton: Në lidhje me faktin pse janë kërkuar dy mostra dhe jo një, si në çdo procedurë, ku autoriteti publik vepron me diskrecionin e vendimmarrjes, për të shmangur çdo mundësi abuzimi kërkojmë dy kopje (në këtë rast mostra) nga të cilat vetëm njëra hapet nga anëtarët e komisionit dhe tjetra qëndron e mbyllur për të sqaruar çdo veprim abuziv të mundshëm të anëtarëve të komisionit. Në çdo rast mostra e dytë, e cila qëndron e pahapur, shërben për ballafaqim dhe verifikim të ankesës apo pretendimit të palëve. Ashtu si është cilësuar edhe në fund të kërkesës nr. 2. 3. 11 të DST-së, mostrat e mallit ju kthehen operatorëve në përfundim të procedurës. Ndërsa, kërkesa për tu mbyllur në zarf është pikërisht

për të siguruar konfidencialitetin e mallrave të operatorëve dhe pamundësinë e hapjes para afateve dhe komisioni përzgjedh njëri nga mostrat (me përzgjedhje) të hapur në momentin e vlerësimit. Ju e kuptoni shumë mirë se termi “zarf” në këtë rast është përdorur me qëllimin e paketimit të përshtatshëm me shënimet e kërkuara më sipër, i cili të sigurojë konfidencialitetin e mallit të ofertuesit dhe sigurinë për të mos u hapur përpara afatit.

6-Një tjetër pretendim i Operatorit ekonomik është: “Nuk keni asnjë mbështetje ligjore mbi kërkesën që do të bëni një javë vlerësimi në praktikë lidhur me përputhjen e modelit.”

Në këtë rast KSHA sqaron: Duke qenë se më sipër argumentuam pse kjo kontratë publike është një kontratë e përzierë midis kontratës së mallrave dhe punës publike, besojmë është e qartë tashmë për operatorin se testimet e punëve publike realizohen në zbatim të legjislacionit për ndërtimet dhe punët publike përpara certifikimit të çdo pune publike.

7- Operatori ankohet se: “Kërkesa që ofertuesi duhet të këtë 35% të mallit në gjendje, është një kërkesë që nuk bazohet në asnjë legjislacion në fuqi, kufizon konkurrencën dhe vë në kushte jo të barabarta konkurrimin e operatorëve ekonomikë të ndryshëm. Shpallja e fituesit nuk është bërë dhe kontrata nuk është lidhur ndaj nuk ka edhe arsye përse të jetë malli gjendje në magazinë. Për këtë arsye kërkojmë heqjen e këtij kriteri”.

Për pretendimin e mësipërm KSHA argumenton: Duke qenë një kërkesë e grupit të specialistëve projektues, është argumentuar në DST, në fund të pikës 2.3.13. Pra është bërë publike në DST dhe është e qartë arsyeja pse është kërkuar. Gjithsesi po e citojmë përsëri: “Ky kriter është i domosdoshëm për shkak të volumit të madh të mallrave të domosdoshme për furnizim dhe vendosje. Për shkak të specifikës së mallrave që kërkohen disponimi i tyre në treg në sasi të madhe është i vështirë dhe në situatën aktualë ku transporti i mallrave është tepër i kufizuar, furnizimi më mallra cilësore nga jashtë vendit është shumë i vështirë çka do të vërë në vështirësi realizimin e kontratës e cila ka si objektiv kursimin e energjisë dhe vënien sa më shpejt në funksionim për të realizuar kursime të shpenzimeve të faturave të energjisë. Për këtë qëllim disponimi i 35% të mallit do të jepte kohë të mjaftueshme operatorit për të furnizuar pjesën tjetër të sasisë.

8-Për sa i takon pretendimit të operatorit “MagUtilities” SHPK në lidhje me pikën 2.3.13 të DST-së: “Ndërkohë në opinionin tonë kriteri i pikës 2.3.13 nuk është i bazuar në ligj dhe rrjedhimisht është antiligjor ndaj dhe kërkojmë heqjen e tij”.

KSHA-ja argumenton: Ky kriter është përcaktuar për të marrë sigurinë e furnizimit dhe vendosjes së mallrave në përputhje me specifikimet teknike. Vetëm në këtë mënyrë do të kemi sigurinë që janë vendosur mallra me cilësinë e kërkuar. Në rast të kundërt furnizimi dhe, vendosja jashtë specifikimeve do të sillte humbjen e qëllimit të kryerjes së këtij investimi.

Për këtë arsye ky kriter duhet të riformulohet nga autoriteti ynë kontraktor duke mos kërkuar deklaratë, por duke sqaruar faktin se pagesa do të kryhet vetëm pasi të provohet efiçenca e energjisë nëpërmjet reduktimit të konsumit të energjisë.

9-Në lidhje me pretendimin e operatorit për preventivin e publikuar: “Keni kërkuar edhe ofertë për mirëmbajtje trevjeçare, por keni harruar se po zhvillonin një procedurë prokurimi të hapur për blerje malli. Pra, i nderuar titullar, ju po anashkaloni një PPP, të cilat aktualisht janë të ndaluara me ligj, duke e publikuar si blerje malli, ndërkohë që nuk është e tillë.”

Siç kemi argumentuar dhe në pikat e sipërpërmendura KSHA-ja edhe në këtë rast arsyeton: Në pikat më sipër ju kemi shpjeguar se kjo kontratë është një kontratë e përzierë (mall dhe punë) dhe ky fakt besoj se ju sqaron mjaftueshëm edhe mbi pretendimet tuaja të cilat i keni shprehur jo qartë më sipër duke pretenduar përtej attributeve ligjore që keni me ligj si operator ekonomik, cilësi me të cilën i jeni drejtuar autoritetit kontraktor.

10-Në lidhje me pretendim e fundit tuajin si operator për specifikimet teknike të cilat i kundërshtoni, KSHA-ja i qëndron argumentimit të grupit të projektuesve dhe specialistëve të fushës si në fillim të procedurës së prokurimit, si më poshtë:

Pika 1. Shkalla e mbrojtjes kundra lagështirës IP67 është kërkuar mbasi zona jonë ka shumë prani bore dhe mund ta konsiderojmë si të zhytur në ujë.

Pika 2. Me ndriçim rrugor kuptojmë lente asimetrike për ndriçues rrugor (jo projektor), këndi i hapjes së dritës me lente rrethore është standard 150° x 55°, në të gjithë prodhuesit e këtyre optikave të lentes e projektorëve ka kënde të ndryshme (nuk kemi kërkuar projektor).

Pika 3-4. Mbas një verifikimi të kujdesshëm në terren për të gjitha shtyllat dhe ndriçuesit kemi konstatuar vetëm një standard të kapjes së krahut apo ndriçuesit D.60 mm që është një standard ndërkombëtar për të gjithë prodhuesit e shtyllave dhe ndriçuesve. Po ashtu dhe shtyllat e betonit kanë diametrin e caktuar ku do të kapet krahu (poshtë kalimit të përcjellësve ku fashetat bëhen me kufi të rregullueshëm).

Pika 5. Përcaktimi në W është kriter tekniko ekonomik, përfitim që ne marrim për shkak të teknologjisë ku një bulbe Led nga 110 lm/w ka arritur në 170 lm/w ku nënkuptohet në përfitim të intesitetit të fluksit të ndriçimit “Efiçenca”

Pika 6. Dimensionet janë thjeshtë orientuese dhe për këtë arsye është kërkuar nga dy mostra, operatori ekonomik mund të sjelli edhe më shumë dhe kjo mbetet në vlerësim të komisionit për të zgjedhur me të përshtatshmen me qëllim unifikimit e të gjithë rrjetit të ndriçimit rrugor pa prishur gjendjen ekzistuese.

Pika 7-8. Është lënë e pa përcaktuar mbasi mund ta përshtatim me strukturat ekzistuese me negociatë brenda çmimit të ofertës. Sasia e kabullit të kërkuar(26,000ml) do të përcaktohet me negociatë brenda vlerës së ofertës sipas kërkesës së objektit.

- Sensor drite dhe çelësa fundor kuptojmë pajisjet e çdo paneli elektrik me këta aksesore që do të përdoren sipas kërkesës të çdo linje në gjithë qytetin dhe fshatrat, gjë e cila nuk përcaktohet paraprakisht.

- Sasitë dhe fuqitë e ndriçuesve ekzistues janë marrë si referencë për të llogaritur se çfarë fuqie dhe sasi të konvertuar me teknologjinë Led mund të vendoset në terren. [...]

II.4. Në datën 19.03.2021, operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilities” SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt, si dhe duke ngritur të njëjtat pretendime me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 06.04.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Në kërkesat për kualifikim keni kërkuar xhiron e viteve 2017, 2018 dhe 2019, ndërkohë që tre vitet e fundit financiare, ashtu sikurse parashikohet në ligj, janë vitet 2018, 2019, 2020.

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, keni kërkuar bilancet, të cilat janë me shumë se tre vitet e fundit, pasi nuk mund të kërkonti bilancin e vitit 2017, si dhe të mos kërkonti bilancin e vitit 2020. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.9, pikat 2.2.a dhe 2.2.b “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“a. Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019) duhet të jetë jo më e vogël se 40% fondit limit që prokurohet. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

b.OE të paraqesë kopje të certifikuar bilanceve të viteve 2017-2018-2019, të konfirmuara nga autoriteti përkatëse, të shoqëruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.1.3. Në nenin 28, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

Ndërsa në pikën 5, gërmat “a” dhe “b” të këtij neni, përcaktohet se: “5. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a)kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose

b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”

III.1.4. Në nenin 29, pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji...”

III.1.5. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se në legjislacionin në fuqi është përcaktuar qartë që autoriteti kontraktor për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, mund të kërkojë kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, si dhe kopje të deklaratave të xhirove vjetore, të paraqitura në autoritetet përkatëse. Lidhur me kërkesën e ankimuesit, për modifikimin e kriterit sa më sipër, duke kërkuar që bilancet e konfirmuara nga autoritetet përkatëse, si dhe deklaratat e xhirove vjetore të kërkojnë për vitet 2018-2019-2020 dhe jo 2017-2018-2019, me argumentin se në tre vitet e fundit financiar nuk duhet të përfshihet viti 2017, por viti 2020, bazuar në faktin që data e zhvillimit të tenderit është 05.04.2021, si dhe afateve të ankimimit, afati i fundit për paraqitjen e deklaratës vjetore në organet tatimore dhe bilancit kontabël (31 Mars) ka kaluar, KPP gjykon, se kërkesa për paraqitjen e vërtetimit për xhiron vjetore dhe bilanceve për vitet 2017-2018-2019, nuk është më në koherencë me përcaktimin kohor të tre viteve të fundit. Në këto kushte, KPP gjykon se tashmë është i nevojshëm modifikimi i kriterit në koherencë me tre vitet e fundit financiar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Lidhur me pagesën e taksave vendore, nuk keni kërkuar vërtetimin që merret për shlyerjen e tyre, por një deklaratë nga shoqëria, e cila nuk provon shlyerjen e taksave vendore.

Nuk ju përputhet numri i mjeteve të kërkuara, me numrin e manovratorëve të kërkuar [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.2.c “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“c. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2020 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar.”

III.2.2. Ndërsa në shtojcën nr.9, pikat 2.3.4 dhe 2.3.6 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.3.4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre minimalisht të punësuar për periudhën e kërkuar nëntor 2020 – janar 2021 të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, shoqëruar me diplomë dhe Cv si dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik sipas profilit ose diplomë me poshtë:

-Inxhinier Elektrik- 1 (një)

-Inxhinier Mekanik - 1 (një)

-Elektracistë 4 (Katër)

-Manovrator - 1 (një)

Ofertuesi duhet të deklarojë personat përgjegjës për projektin, stafin kryesor të inxhinierëve dhe të sigurojë informacione përkatëse për kualifikimet, përvojën dhe certifikimin e tyre.

2.3.6. *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca10/1):*

-Autokullë me kosh 1 (Nje)

-Kamionçin për transport (Nje)

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 10 /1 të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

•Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre. Për mjetet, nëse janë me qira, duhet të paraqiten kontratat e qirase ku afati i marrjes me qira të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.

•Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.

•Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qirasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.

•Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, duke patur parasysh perdorimin e tyre sipas grafikut të punimeve.”

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët

ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, KPP-ja gjykon se këto në thelb kanë të bëjnë me shtim të dokumentacionit provues ose kërkesave për kualifikim, dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve për kualifikim si diskriminuese, apo kufizuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP-ja gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.”* KPP-ja gjykon, se që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit apo specifikimeve teknike pranë këtij të fundit, duke iu dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit/specifikime teknike), të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP-ja gjykon se autoriteti kontraktor ka përaktuar kriteret e kualifikimit që ka gjykuar të nevojshme për tu siguruar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku në nenin 63 pika 4 gërma “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret e kualifikimit që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP-ja gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret e kualifikimit janë në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin

Publik” i ndryshuar), por mbi shtimin kriterëve të kualifikimit, apo dokumentacionit provues për përmbushjen e tyre në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP-ja gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret e kualifikimit, në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, KPP-ja në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret e kualifikimit, apo dokumentacionin provues për përmbushjen e tyre, në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Lidhur me shërbimet e ngjashme, keni kërkuar kërkesat e DST për punë publike, ndërkohë që ju e keni procedurën e prokurimit blerje malli. Në asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore nuk ka të parashikuar për rastin e blerjes së mallit që ky kriter plotësohet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe në BOE, në kundërshtim kjo me nenin 74 të VKM. Gjithashtu, në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik keni kërkuar formular vlerësimi, i cili kërkohet vetëm në DST për punë publike, si dhe kontratën, të cilat janë kërkesa antiligjore. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.1 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

2.3.1.a) Furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Pika a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesmarrjes në bashkim . Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim .

Plotësimi i këtij kushti të sipërpërmendur e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon:

2.3.1.A Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1.Formularin e vlerësimit (Vërtetim)

2.Kontratën/Kontratata

3.Faturën përfundimtare tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi:

2.3.1.B Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1.Fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastet e bashkimit të operatorëve të paraqitet kontrata noteriale e bashkëpunimit.”

III.3.2. Në “Njoftimin e kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar si vijon:

“2.2Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III.3.3. Në nenin 3, pika 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

6. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.

III.3.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 4 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

III.3.5. Në nenin 26 “Kontratat e Punëve Publike”, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”

III.3.6. Në nenin 74, paragrafi i katërt i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Në këtë kontekst, për sa i përket pretendimit të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar kërkesave të autoritetit kontraktor si më sipër cituar, si dhe referuar specifikimeve teknike të procedurës objekt ankimi ky i fundit ka parashikuar “rikonstruksionin” e ndriçimit rrugor me ndriçues, kontratë e cila parashikon furnizimin dhe vendosjen e ndriçuesve dhe shtyllave, si dhe mirëmbajtjen e tyre për një periudhë tre vjeçare. Pra objekti i prokurimit rezulton një procedurë e cila përmban në vetvete furnizimin me shtylla dhe ndriçues, shërbimin e vendosjes dhe mirëmbajtjes së tyre dhe në asnjë rast nuk është kërkuar ndonjë zë punimi ndërtimi. Në kushtet kur procedura në fjalë është “kontratë furnizimi” kërkesat e autoritetit kontraktor: *“Pika a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim . Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Plotësimi i këtij kushti të sipërpërmendur e bën ofertën të kualifikueshme”*, i referohet kërkesave të parashikuara në rregullat e prokurimit publik lidhur me kontratat e punëve, gjë e cila nuk përputhet me llojin e kontratës objekt prokurimi “Kontratë furnizimi”, siç parashikohet në nenin 27 të VKM-së si më sipër cituar. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke e hartuar atë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: *“[...]Keni kërkuar kategorinë e licencës NP 11, ndërkohë që kjo kategori është vetëm për punime ndërtimore dhe jo për blerje malli. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.2 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.3.2. Operatori për realizimin e punimeve të vendosjes së mallrave që kërkohen duhet të disponojë:

-Licencën e shoqërisë N.P.- 11 B (Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.)”

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.4.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.4.4. Në Lidhjen 3 “Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet:

“N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.”

III.4.5. Në preventivin e kontratës objekt prokurimi, rezulton se janë parashikuar të kryhen furnizimet me mallra/shërbime si vijon:

PREVENTIVI PËR NDRIÇIMIN PUBLIK (RIKONSTRUKSION)

NR.	ARTIKULLI	MODELI	NJËSIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	<i>F.V Ndriçues</i>	1	<i>copë</i>	505		
2	<i>F.V Ndriçues</i>	2	<i>copë</i>	465		
3	<i>F.V Ndriçues</i>	3	<i>copë</i>	311		
4	<i>F.V Ndriçues</i>	4	<i>copë</i>	1,914		
5	<i>F.V Ndriçues</i>	5	<i>copë</i>	60		
6	<i>F.V Ndriçues</i>	6	<i>copë</i>	15		
7	<i>F.V shtylla</i>	<i>Tipi 1</i>	<i>copë</i>	100		
8	<i>F.V krahë</i>	<i>Tipi 2/ Tipi 3</i>	<i>copë</i>	500		
9	<i>F.V përcjellës i veshur</i>		<i>m/l</i>	26,000		
10	<i>Sensorë drite dhe çelësa fundore</i>		<i>copë</i>	2,500		
11	<i>Mirëmbajtje</i>		<i>vite</i>	3		
	Total pa TVSH	-				
	TVSH 20%	-				
	Vlera me TVSH	-				

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së.

III.4.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të

arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P-ja gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, referuar preventivit dhe specifikimeve teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit, Komisioni gjykon se kriteri lidhur me disponimin e kategorisë NP-11 B (*Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.*), të licencës të punimeve profesionale të zbatimit, nuk është në përputhje me natyrën dhe zërat e preventivit të kontratës që prokurohet, pasi objekti i prokurimit nuk është veprimtari e mirëfilltë ndërtimi dhe zërat e kërkuar për realizimin e tij nuk janë instalim shtyllash metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdolloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore, por janë thjesht instalime shtyllash ndriçimi dhe ndriçuesish. Në këtë kuptim KPP-ja gjykon se referuar, natyrës së furnizimeve të mësipërme, kjo kërkesë e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale dhe nuk është e nevojshme për realizimin e zërave të preventivit të kontratës objekt ankimi, pasi këto zëra nuk përfshihen në përkufizimin për këtë kategori licence. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar Lidhjes 3 të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, si dhe natyrës së furnizimeve të objektit të kontratës, së bashku me preventivin të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, vlerëson se nga autoriteti kontraktor është kërkuar licencë që nuk lidhet drejtpërdrejtë me objektin e kontratës objekt prokurimi. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me disponimin e kategorisë së licencës NP-11 B (*Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.*), është një kërkesë e ekzagjeruar dhe tejkalon objektin e kontratës që prokurohet e për rrjedhojë kriteri për paraqitjen e kësaj licence duhet të hiqet nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Keni kërkuar licencë për auditim energjie në ndërtesa, ndërkohë që ju po zhvilloni një procedurë prokurimi blerje malli”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.5 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: “2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë një person të punësuar që të disponojë certifikatën “Për auditimin ne energji në ndërtesa dhe instalime industriale”

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.5.3. Në nenin 4, të ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë”, i ndryshuar parashikohet se:

“ [...]Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Auditim energjetik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të eficientësisë së energjisë

“Ndërtesë” është një konstruksion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm.;

“Objekt industrial” është një ndërtesë e destinuar për ushtrimin e proceseve të ndryshme industriale. [...]”

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.5.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: “2. *Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e*

prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”

III.5.6. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e punonjësit Auditues energjetik i certifikuar për të kryer auditime në ndërtesa dhe në instalime industriale KPP-ja gjykon, se në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, se operatorët ekonomik ofertues, disponojnë në stafin e tyre, kapacitetet e duhura teknike për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet. Por, kërkesa e autoritetit kontraktor se duhet të disponohet një punonjës Auditues energjetik i certifikuar për të kryer auditime në ndërtesa dhe në instalime industriale është një kërkesë e ekzagjeruar dhe diskriminuese, e cila nuk është në proporcion dhe në përputhje me objektin e prokurimit. Komisioni gjykon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor të kërkojë staf teknik sipas nevojave për realizimin me sukses të kontratës, por nuk duhet të kufizojë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, duke përcaktuar në mënyrë të pajustificuar disponimin e një punonjësi Auditues energjetik i certifikuar për të kryer auditime në ndërtesa dhe në instalime industriale, ndërkohë që për realizimin e kontratës objekt prokurimi, operatorët ekonomik nuk do të kryejnë asnjë shërbim për të cilën nevojitet punonjësi për auditime në ndërtesa dhe në instalime industriale, sipas kuptimit të ligjit nr. 124/2015 “Për eficientësinë e energjisë”, i ndryshuar. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin e mësipërm, nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] Në DST keni kërkuar deklaratë për mirëmbajtje 3 vjeçare, ndërkohë që procedura e prokurimit që ju po zhvilloni është blerje malli.

Në preventivin e publikuar, keni kërkuar edhe ofertë për mirëmbajtje tre vjeçare, por keni harruar se po zhvilloni një procedurë prokurimi të hapur për blerje malli. Pra, i nderuar titullar, ju po anashkaloni një PPP, të cilat aktualisht janë të ndaluara me ligj, duke e publikuar si blerje malli, ndërkohë që nuk është e tillë.

Në kushtet e mësipërme, kërkojmë anulimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit, pasi keni zbatuar DST të ndryshme për sa kërkonin në kërkesat për kualifikim, ose vendosjen e tyre sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se::

III.6.1. Në “Njoftimin e kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar si vijon:

“2.2Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

<i>Blerje</i>	<i>Qira</i>	<i>Leasing</i>	<i>Blerje me këste</i>	<i>Një kombinim i tyre</i>
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

III.6.2. Në nenin 3, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“5. “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike që kanë objekt kryerjen e shërbimeve. Kontrata publike, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë publike për shërbime”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë. Kontratat publike, që kanë objekt shërbimet, por që përfshijnë edhe punime të lidhura në mënyrë dytësore me objektin kryesor të kontratës, vlerësohen “kontrata publike për shërbime”.

6. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit

8. “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.

9. “Punim” është përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik”

III.6.3. Nga shqyrtimi i objektit të prokurimit, si dhe tabelës së preventivit (*shih paragraf III.4.5*), Komisioni konstaton se, objekti i kontratës që prokurohet është furnizimi dhe vendosja e shtyllave të ndriçimit dhe ndriçuesve, si dhe shërbimi i mirëmbajtjes së tyre për tre vite. Gjithashtu konstatohet se dokumentet e tenderit janë hartuar në përputhje me nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi dukshëm objekti kryesor i kontratës që prokurohet është furnizimi me mallra. Në këto kushte, referuar volumit të objektit kryesor të prokurimit, Komisioni gjykon, se përcaktimi i kontratës që prokurohet si kontratë për furnizim për mallra, është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, pavarësisht se në këtë kontratë janë parashikuar shërbime mirëmbajtjeje. Sa më lart, pretendimet se kjo kontratë duhej klasifikuar si PPP, apo pretendimet që kjo procedurë prokurimi duhet anuluar, Komisioni gjykon se janë të pabazuara.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Keni kërkuar nga 2 mostra për secilin tip ndriçuesi dhe nuk e kuptojmë përse duhen dy dhe jo një. Nuk keni asnjë mbështetje ligjore mbi kërkesën që do të bëni një javë vlerësimi në praktikë lidhur me përputhjen e modelit.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.11 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: “2.3.11.Operatori ekonomik do të dorëzojë nga 2 mostra për secilin tip ndriçuesi, që ka parashikuar në ofertë, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës së hapjes së procedurës së prokurimit. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mostrat duhet të dorëzohen jo më vonë se data dhe ora e

hapjes së ofertave në adresën Bashkia Pogradec, Igj. Nr. 2 Bulevardi Rreshit Çollaku, Pogradec dhe shkresa do të protokollohet në zyrën e protokollit në Bashki.

Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).

Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

Në këtë mënyrë do të bëhet vlerësimi në praktikë për një periudhë prej një jave i përputhjes së modelit me të dhënat teknike të dhëna në ofertë. Për seksionin rrugor të zgjedhur, fuqia maksimale [W] dhe konsumi i energjisë [kWh] do të matet ose llogaritet.

Kërkesa për mostrën e mallarve është e domosdoshme për shkak të ekzistencës në tregun e brendshëm të mallrave të pacertifikuara, me materiale jo sipas specifikimeve teknike dhe me eficiencë energjie jo të përshtatshme sipas kërkesave teknike, cka në fakt është dhe qëllimi dhe objektivi i këtij investimi për eficiencën e energjisë, në mënyrë që reduktimi i konsumit të energjisë të vetëshlyejë investimin.

Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”

III.7.2. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin. “

III.7.3. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose “

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin e kriterëve specifike, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, përcaktojnë kriteret e kualifikimit duhet të jenë: *(i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.* Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike (referuar nenit 12 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar” të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor, të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Ligjvënësi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithëpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit me rëndësinë që ka për vlerësimin e ofertës teknike. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Synimi i autoritetit kontraktor është shprehur në disa drejtime si në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi në të cilën ka parashikuar mbi cilësinë dhe specifikimet teknike të produktit final. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik (makineri, staf etj.) si edhe kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP-ja gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin nga 2 copë mostra për secilin tip ndriçuesi është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon se, është e mjaftueshme që operatorët ekonomik pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për secilin tip ndriçuesi me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar sipas konstatimeve të mësipërme.

III.7.5. Ndërsa lidhur me përcaktimin e autoritetit kontraktor se do të bëhet vlerësimi në praktikë për një periudhë prej një jave i përputhjes së modelit me të dhënat teknike të dhëna në ofertë, Komisioni gjykon se, në rastin konkret qëllimi i kërkimit të mostrës është që të verifikohen dhe testohen produktet e ofruara nga operatorët ekonomik, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet plotësisht se këto produkte përputhen me specifikimet teknike dhe qëllimin kryesor të objektit të prokurimit. Komisioni thekson se, për sa kohë që autoritetet kontraktore mund të kryejnë teste ndaj mostrave me qëllim që të sigurohen plotësisht se këto produkte përputhen me specifikimet teknike, si dhe bazuar në faktin që neni 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar i detyron autoritetet kontraktore që ti kenë në kontroll këto mostra deri 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës ose deri në 30 ditë nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit, periudha e testimit prej një jave nuk bie ndesh me asnjë parashikim ligjor në fuqi për prokurimin publik. Akoma më tej, operatori ekonomik ankimues, në asnjë rast nuk ka argumentuar, apo provuar dëmin apo pasojat e ardhura nga ky veprim i autoritetit kontraktor. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Kërkesa që ofertuesi duhet të ketë 35% të mallit në gjendje, është një kërkesë që nuk bazohet në asnjë legjislacion në fuqi, kufizon konkurrencën dhe vë në kushte jo të barabarta konkurrimin e operatorëve ekonomikë të ndryshëm. Shpallja e fituesit nuk është bërë dhe kontrata nuk është lidhur ndaj nuk ka edhe arsye përse të jetë malli gjendje në magazinë. Për këtë arsye kërkojmë heqjen e këtij kriteri. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.12 “Për kapacitetin teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.3.12.Operatori ekonomik duhet te disponoje gjendje te mallit ne magazine minimalisht 35 % te produkteve te kerkuara ne kete procedure prokurimi .12.1. Operatori ekonomik duhet te dorezoje nje deklarate ne te cilen te prezantoje gjendjen ne magazine te mallit qe disponon.

Operatori ekonomik duhet te jete i gatshem per pranuar nje vizite kontrolli nese e sheh te domosdoshme Komisioni i vleresimit te ofertave per te pare dhe vertetuar gjendjen ne magazinën e OE ofertues. Shenim: Komisioni i Vleresimit te Ofertave rezervon te drejten e verifikimit te deklaratave te leshuara nga Operoret Ekonomik.

Ky kriter është i domosdoshëm për shkak të volumit të madh të mallrave të domosdoshme për furnizim dhe vendosje. Për shkak të specifikës së mallrave që kërkohen, disponimi i tyre në treg në sasi të madhe është i vështirë dhe në situatën aktualë ku transporti i mallrave është tepër i kufizuar, furnizimi më mallra cilësorë nga jashtë vëndit është shumë i vështirë çka do të vendosë në vështirësi realizimin e kontratës e cila ka si objektiv kursimin e energjisë dhe vënien sa më shpëjt në funksionim për të realizuar kursime të shpenzimeve të faturave të energjisë. Për këtë qëllim disponimi i 35% të mallit do ti jepte kohë të mjaftueshme operatorit për të furnizuar opjesën tjetër të sasisë.”

III.8.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.8.3. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomik duhet të kenë minimalisht 35% të mallit objekt prokurimi gjendje në magazinë, Komisioni gjykon se kjo kërkesë është kufizuese në mënyrë të panevojshme, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që mallrat objekt prokurimi, gjatë zbatimit të kontratës, të dorëzohen në përputhje të plotë me specifikimet teknike, cilësitë, si dhe brenda afateve, sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit. KPP-ja gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sa më sipër, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të heqë këtë kriter nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, përfituesi i drejtpërdrejtë i mallrave të kërkuar është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave dhe aftësia për të realizuar me sukses kontratën brenda afateve të përcaktuara, është e njëjtë me cilësinë dhe afatet e premtuara në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Ndërkohë në opinionin tonë kriteri i pikës 2.3.13 nuk është i bazuar në ligj dhe rrjedhimisht është antiligjor ndaj dhe kërkohet heqjen e tij.

2. AK kërkohen këndin e hapjes së dritës prej 150°, ndërkohë që ky kënd për ndriçim rrugor duhet të jetë asimetrik që do të thotë, që duhet të shprehet në dy dimensione p.sh. 150° x55°[...]

Komisioni konstaton, se komisioni i shqyrtimit të ankesave i ka pranuar në parim këto pretendime si vijon: “[...]KSHA-ja argumenton: Ky kriter është përcaktuar për të marrë sigurinë e furnizimit dhe vendosjes së mallrave në përputhje me specifikimet teknike. Vetëm në këtë mënyrë do të kemi sigurinë që janë vendosur mallra me cilësinë e kërkuar. Në rast të kundërt

furnizimi dhe vendosja jashtë specifikimeve do të sillte humbjen e qëllimit të kryerjes së këtij investimi. Për këtë arsye ky kriter duhet të riformulohet nga autoriteti ynë kontraktor duke mos kërkuar deklaratë, por duke sqaruar faktin se pagesa do të kryhet vetëm pasi të provohet eficienta e energjisë nëpërmjet reduktimit të konsumit të energjisë.

Pika 2. Me ndriçim rrugor kuptojmë lente asimetrike për ndriçues rrugor (jo projektor), këndi i hapjes së dritës me lente rrethore është standard $150^\circ \times 55^\circ$, në të gjithë prodhuesit e këtyre optikave të lentes e projektorëve ka kënde të ndryshme (nuk kemi kërkuar projektor). [...]” Por, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën përkatëse për të pasqyruar ndryshimet sipas konstatimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesave. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se pretendimet e mësipërme janë pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këto të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithsesi në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimmarrjes së K.P.P-së duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nuk keni specifikuar se kush quhet ngjyrë e ndezuar, meqenëse i kërkon katalogët me këtë ngjyrë.

3. Për çdo tipologji ndriçimi duhet të na përcaktoni mënyrën e kapjes në shtyllë dhe gjithashtu dhe diametrin e kapjes për çdo tipologji/model . Sa ndriçues do të lidhen direkt në shtyllë dhe sa do të jetë dimensiononi në pikën e lidhjes së ndriçuesit me shtyllën. Gjithashtu kush tip/model ndriçuesi do të lidhet direkt në shtyllë. Sa ndriçues do të lidhen me krahë në shtyllë dhe sa do të jetë dimensiononi në pikën e lidhjes së ndriçuesit me krahun e shtyllës. Gjithashtu kush tip/model ndriçues do të lidhet me krahun e shtyllës. Është shumë e paqartë mënyra e montimit të ndriçuesit model 4.

4. Ndriçuesi model 5 nuk kuptohet nëse: vizatimi i skedës teknike është i ndriçuesit apo vetëm një pjesë e tij është ndriçues dhe pjesa tjetër është shtyllë. Ju lutem përcaktoni më qartë.

Gjithashtu nëse një pjesë e skicës së paraqitur në Skicën e Ndriçuesit model 5 nga ana Juaj është shtyllë, përcaktoni edhe mënyrën e montimit të saj me tokën.

Ju lutem na sqaroni se ku mund ti gjejmë zarfet që të mbyllim mostrat e ndriçimit.

10. Në dokumentin me emërtim skica specifikime përfundimtare.doc, në faqet 76-79 janë disa tabela që kanë sasitë dhe fuqitë e ndriçuesve ekzistues dhe atyre që do të vendosen. Ne dëshirojmë të dimë nëse duhet ti referohemi këtij dokumenti për të bërë ofertën tonë apo dokumentit me emërtim PREVENTIVI PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike. Në rastin konkret, KPP-ja gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues apo specifikimi teknik është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e tyre dhe ka parashtruar pyetje. Gjithashtu, KPP-ja konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili

duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”, ka dhënë sqarimet për operatorin ekonomik ankimues, lidhur me kriterin e veçantë të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “[...]Pika 3-4. Mbas një verifikimi të kujdesshëm në terren për të gjitha shtyllat dhe ndriçuesit kemi konstatuar vetëm një standard të kapjes së krahut apo ndriçuesit D.60 mm, që është një standard ndërkombëtar për të gjithë prodhuesit e shtyllave dhe ndriçuesve. Po ashtu dhe shtyllat e betonit kanë diametrin e caktuar ku do të kapet krahu (poshtë kalimit të përcjellësve ku fashetat bëhen me kufi të rregullueshëm).

Ndërsa kërkesa për tu mbyllur në zarf është pikërisht për të siguruar konfidencialitetin e mallrave të operatorëve dhe pamundësinë e hapjes para afateve dhe komisioni për zgjedh njëri nga mostrat (me përzgjedhje) të hapur në momentin e vlerësimit. Ju e kuptoni shume mirë se termi “zarf” në këtë rast është përdorur me qëllimin e paketimit të përshtatshëm me shënimet e kërkuara më sipër, i cili të sigurojë konfidencialitetin e mallit të ofertuesit dhe sigurinë për të mos u hapur përpara afatit.

- Sasitë dhe fuqitë e ndriçuesve ekzistues janë marrë si referencë për të llogaritur se çfarë fuqie dhe sasi të konvertuar me teknologjinë Led mund të vendoset në terren. [...], por këto sqarime në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së, autoriteti kontraktor nuk i ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Gjithashtu, konstatohet se, autoriteti kontraktor nuk i ka bërë të plota sqarimet. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë sqarimet e plota, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

III.11. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]1.AK kërkon nivel mbrojtjeje IP67 i cili është i vlefshëm për ndriçues që zhyten nën ujë. Niveli më i lartë i mbrojtjes për ndriçimin rrugor është IP66 ndaj duhet zëvendësuar IP67 me IP66

5. Në skicat e modeleve të vëna në dispozicion nga AK, përcaktohet fuqia në watt. Mirëpo sasia e ndriçimit të nevojshëm dhe të kërkuar përcaktohet në Lm dhe jo në watt dhe ky kriter pengon OE, që të bëjnë një ofertë e cila mund të ofronte të njëjtën sasi ndriçimi në Lm duke konsumuar me pak energji në watt, gjë e cila do të sillte një përfitim ekonomik AK.

Pra ne kërkojmë që ky kriter të hiqet pasi nuk lejon që të ofrohen ndriçues me efikasitet më të lartë që i sjellin edhe kursim AK. Duke mos e hequr këtë kriter AK bëhet shkas e një dëmi të mundshëm ekonomik ndaj institucionit pasi pengon mundësinë e ofertimit të ndriçuesve me efikasitet më të lartë.

6. AK kërkon dimensione fikse të ndriçuesve, gjë e cila është kriter diskriminues dhe na shtyn të mendojmë që në këtë garë është paracaktuar fituesi. Cfarë do të ndryshonte në ndriçimin e kërkuar nëse dimensionet do të ishin të përafërta dhe jo ekzakte, mos vallë nuk do të ndriçohej rruga?

Kriteret që përcaktojnë e ndriçimit të rrugës janë Lm dhe jo dimensionet e ndriçuesit, ndaj edhe ne kërkojmë që ky kriter të hiqet.

7. Në tabelën me përmasat e shtyllave nuk janë përcaktuar të gjitha dimensionet e shtyllës. Më saktësisht në shtyllën model 2 dhe model 3 nuk përcaktohet se në çfarë Ø duhet të jetë tubi i këtij modeli.

Në dokumentin me emërtim PREVENTIV PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc kërkon F.V përcjellës i veshur 26,000 ml pa përcaktime teknike gjë që në opinionin tonë lë hapësira për interpretim dhe abuzim në kuotimet që do të bëhen nga cdo OE. Ju lutemi përcaktoni se çfarë duhet ekzaktësisht. Në dokumentin me emërtim PREVENTIVI PËR NDRICIMIN PUBLIK.doc kërkon F.V. Sensorë drite dhe çelësa fundore 2,500 copë pa dhënë specifikime teknike për secilin dhe pa përcaktuar sasinë për secilën gjë që në opinionin tonë lë hapësira për interpretim dhe abuzim në kuotimet që do të bëhen nga çdo OE. Ju lutemi përcaktoni se çfarë duhet ekzaktësisht.

9. Në dokumentin me emërtim skica specifikime përfundimtare.doc, tabelat e shpërndarjes së ndriçuesve sipas rrugëve nuk janë të lexueshme. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në shtojcën “Skica specifikime përfundimtare”, të ngarkuar në SPE, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

LED PER PËRDORIM TE JASHEM		MODEL NR. 1	SKEDË TEKNIKE												
	IP67	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2">TË DHËNA FOTOMETRIKE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>90 W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>15300 lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </tbody> </table>	TË DHËNA FOTOMETRIKE		TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	90 W	LUMEN	15300 lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70	°C -40/+50
	TË DHËNA FOTOMETRIKE														
TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K														
FUQIA	90 W														
LUMEN	15300 lm														
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°														
CRI / IRC / CRI	>70														
	CE														
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM														
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER														
HYRJE	AC 230V - 50Hz														
JETËGJATËSIA	100'000 h														

LED PER PËRDORIM TE JASHEM		MODEL NR. 2	SKEDË TEKNIKE												
	IP67	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2">TË DHËNA FOTOMETRIKE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>60W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>10200 lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </tbody> </table>	TË DHËNA FOTOMETRIKE		TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	60W	LUMEN	10200 lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70	°C -40/+50
	TË DHËNA FOTOMETRIKE														
TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K														
FUQIA	60W														
LUMEN	10200 lm														
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°														
CRI / IRC / CRI	>70														
	CE														
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM														
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER														
HYRJE	AC 230V - 50Hz														
JETËGJATËSIA	100'000 h														

LED PER PËRDORIM TE JASHEM

MODEL NR. 3

SKEDË TEKNIKE

	IP67	TË DHËNA FOTOMETRIKE <table border="1"> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>30W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>5100 lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </table>	TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	30W	LUMEN	5100 lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70
	TEMPERATURA E NGJYRËS		4000K									
FUQIA	30W											
LUMEN	5100 lm											
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°											
CRI / IRC / CRI	>70											
°C -40/+50	CE											
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM											
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER											
HYRJE	AC 230V - 50Hz											
JETËGJATËSIA	100'000 h											

LED PER PËRDORIM TE JASHEM

MODEL NR. 4

SKEDË TEKNIKE

	IP67	TË DHËNA FOTOMETRIKE <table border="1"> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>30W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>5100 lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </table>	TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	30W	LUMEN	5100 lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70
	TEMPERATURA E NGJYRËS		4000K									
FUQIA	30W											
LUMEN	5100 lm											
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°											
CRI / IRC / CRI	>70											
°C -40/+50	CE											
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM											
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER											
HYRJE	AC 230V - 50Hz											
JETËGJATËSIA	100'000 h											

LED PER PËRDORIM TE JASHEM SKEDË TEKNIKE


Ndricues Model Nr. 5

	°C -40/+50	TË DHËNA FOTOMETRIKE <table border="1"> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>10W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>1 700 lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </table>	TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	10W	LUMEN	1 700 lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70
	TEMPERATURA E NGJYRËS		4000K									
FUQIA	10W											
LUMEN	1 700 lm											
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°											
CRI / IRC / CRI	>70											
IP67	CE											
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM											
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER											
HYRJE	AC 230V - 50Hz											
JETËGJATËSIA	100'000 h											

LED PER PËRDORIM TE JASHEM SKEDË TEKNIKE

Ndricues Model Nr. 6

	°C -40/+50	TË DHËNA FOTOMETRIKE <table border="1"> <tr> <td>TEMPERATURA E NGJYRËS</td> <td>4000K</td> </tr> <tr> <td>FUQIA</td> <td>40W</td> </tr> <tr> <td>LUMEN</td> <td>6 800lm</td> </tr> <tr> <td>KËNDI I HAPJES SË DRITËS</td> <td>150°</td> </tr> <tr> <td>CRI / IRC / CRI</td> <td>>70</td> </tr> </table>	TEMPERATURA E NGJYRËS	4000K	FUQIA	40W	LUMEN	6 800lm	KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°	CRI / IRC / CRI	>70
	TEMPERATURA E NGJYRËS		4000K									
FUQIA	40W											
LUMEN	6 800lm											
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	150°											
CRI / IRC / CRI	>70											
IP67	CE											
PËRSHKRIMI	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHEM											
STRUKTURA	TRUP PREJ ALUMINI I LYER											
HYRJE	AC 230V - 50Hz											
JETËGJATËSIA	100'000 h											



III.11.2. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve*

të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj."

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin."

Gjithashtu në nenin 27 "Kontratat e Mallrave" pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.[...]"

III.11.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi përcaktimin e parametrave të fuqisë dhe dimensioneve të ndriçuesve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të specifikimeve teknike i ka përcaktuar ato në mënyrë fikse. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e aktit normativ në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Përcaktimi në mënyrë fikse i specifikave të mallrave objekt prokurimi, duke i kufizuar në mënyrë eksplicite ato, kufizon pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi e për pasojë kufizon konkurrencën, pasi do të privonte nga ofertimi operatorë ekonomikë të ndryshëm, të cilët mund të ofertojnë ndriçues me kapacitete me të mira dhe më eficientë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet ti rihartojë specifikimet teknike për artikujt e mësipërm duke mos përcaktuar përmasa apo kapacitete të tjera fikse për elementë të cilat nuk ndikojnë në qëllimin kryesor e këtyre artikujve, por të vendosë diapazon dhe/ose minimum/maksimum lidhur me fuqinë dhe përmasat e mallrave objekt prokurimi.

III.11.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi mospërcaktimin e të gjitha përmasave të shtyllave dhe specifikimeve teknike minimale të përcjellësve, sensorëve të dritës dhe çelësave fundorë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka hartuar të gjitha specifikimet teknike të shtyllave model 2 dhe model 3, si dhe nuk ka përshkruar minimumin e kërkesave, që duhet të kenë produktet që kërkon të furnizohet me anë të kësaj procedure prokurimi për sensorët e dritës dhe çelësave fundorë. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë përshkrimin funksional të mallit, si dhe specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale specifikimet e mallrave për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni gjykon se nga përshkrimi i mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i furnizimit së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë furnizim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, kërkesat e funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë minimumin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi, gjithmonë në përputhje me nenin 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III.11.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi paqartësinë e tabelave të shpërndarjes së ndriçuesve sipas rrugëve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, shkrimi brenda tabelave nga faqja 5 deri në faqen 75 të shtojcës “Skica specifikime përfundimtare”, janë tërësisht të palexueshme, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 23, të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pasi specifikimet teknike duhet të hartohen të qarta dhe të sakta, në mënyrë që të jenë të kuptueshme edhe nga personat me aftësi të kufizuara. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet ti ringarkojë këto tabela në SPE me një rezolucion më të mirë, në mënyrë që shkrimi brenda këtyre tabelave të jetë i lexueshëm dhe i qartë.

III.11.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi nivelin e mbrojtjes nga hyrja (IP) të ndriçuesve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, vlerësimet IP përcaktohen në standardin ndërkombëtar EN 60529 (British BS EN 60529: 1992, European IEC 60509: 1989). Ato përdoren për të përcaktuar nivelet e efektivitetit të mbylljes së pajisjeve elektrike kundër ndërhyrjes nga trupat e huaj (mjetet, papastërtitë etj.) dhe lagështisë. Referuar standardeve të sipërpërmendura, niveli i mbrojtjes IP67 garanton mbrojtjen totalisht nga papastërtitë, si dhe mbrojtjen nga lagështia të pajisjeve që janë nën ujë nga 15 cm deri në 1 metër thellësi. Në këto kushte, referuar objektit të procedurës së prokurimit, Komisioni gjykon se përcaktimi i nivelit të mbrojtjes IP67 është i ekzagjeruar dhe kufizues në mënyrë të panevojshme, pasi autoriteti kontraktor po prokuron ndriçues të cilët nuk do të instalohen nën ujë. Komisioni sqaron, se në kriteret ndërkombëtare lidhur me ndriçimin dhe sinjalistikën rrugore konsiderohen të mjaftueshme edhe nivele mbrojtjeje më të ulta, të cilat krijojnë sigurinë e mjaftueshme për jetëgjatësinë e ndriçuesve. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimin teknik të mësipërm duke ulur nivelin e mbrojtjes IP, si dhe duke mos e përcaktuar në mënyrë fikse, me qëllim lejimin e mundësisë për ofertimin edhe të ndriçuesve me nivel mbrojtje më të lartë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.12. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Mag-Utilites” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]8. Tek tabela e modeleve në dokumentin me emërtim *skica specifikime përfundimtare.doc*, sasia e ndriçuesit model 3 është 315 copë, model 4 është 1915 copë, model 6 është 10 copë dhe sasi të krahëve metalik model 2 dhe model 3 janë të përcaktuara më vete për secilin model, ndërkohë që në dokumentin me emërtim **PREVENTIVI PËR NDRIÇIMIN PUBLIK.doc** për ndriçuesin model 3 kërkoni 311 copë, modelin 4 kërkoni 1914 copë, modelin 6 kërkoni 15 copë dhe për shtyllat model 2 dhe model 3 kërkoni në total 500 copë por pa specifikuar sa prej secilit model [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1. Në preventivin e kontratës objekt prokurimi, rezulton se janë parashikuar të kryhen furnizimet me mallra/shërbime si vijon:

PREVENTIVI PËR NDRIÇIMIN PUBLIK (RIKONSTRUKSION)						
NR.	ARTIKULLI	MODELI	NJËSIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	<i>F.V Ndriçues</i>	1	<i>copë</i>	505		
2	<i>F.V Ndriçues</i>	2	<i>copë</i>	465		
3	<i>F.V Ndriçues</i>	3	<i>copë</i>	311		
4	<i>F.V Ndriçues</i>	4	<i>copë</i>	1,914		
5	<i>F.V Ndriçues</i>	5	<i>copë</i>	60		
6	<i>F.V Ndriçues</i>	6	<i>copë</i>	15		
7	<i>F.V shtylla</i>	<i>Tipi 1</i>	<i>copë</i>	100		
8	<i>F.V krahë</i>	<i>Tipi 2/ Tipi 3</i>	<i>copë</i>	500		
9	<i>F.V përcjellës i veshur</i>		<i>m/l</i>	26,000		
10	<i>Sensorë drite dhe çelësa fundore</i>		<i>copë</i>	2,500		
11	<i>Mirëmbajtje</i>		<i>vite</i>	3		
	Total pa TVSH	-				
	TVSH 20%	-				
	Vlera me TVSH	-				

III.12.2. Në shtojcën “Skica specifikime përfundimtare”, të ngarkuar në SPE, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

	<i>Sasia e kërkuar</i>	<i>fuqia e ndriçuesit W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 1</i>	505	<i>cope 90W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 2</i>	465	<i>cope 60W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 3</i>	315	<i>cope 30 W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 4</i>	1915	<i>cope 40 W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 5</i>	60	<i>cope 40 W</i>
<i>F.V ndriçuesi model 6</i>	10	<i>cope 30 W</i>
<i>F.V Krah Metalik me qafore për shtyllë betoni/druri/hekuri</i>	410	<i>cope</i>

<i>model tipi 3 sipas tabelës</i>		
<i>F.V Krahë metalik për kapje në mur sipas tabelës Tipi 2</i>	90	<i>cope</i>
<i>F.V Shtyllë Metalike 5/8 metër linear sipas tabelës Tipi 1</i>	100	<i>cope</i>

III.12.3. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”

III.12.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni vëren, se ky i fundit ngre pretendime mbi mospërputhjen e specifikimeve teknike me preventivin. Nga verifikimi i kryer në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni gjithashtu e konstaton mospërputhjen e ndërmjet tyre, duke shkaktuar paqartësi të operatorët ekonomik të interesuar, për hartimin e ofertave. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka lënë vend për konfuzion, pasi ka mospërputhje ndërmjet sasive, duke përcaktuar sasi të ndryshme furnizimi që duhet të kryejë operatori ekonomik pjesëmarrës. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të unifikojë kërkesat ndërmjet preventivit dhe specifikimeve teknike, në mënyrë që të krijohet panoramë e qartë mbi furnizimet që do të kryhen, si dhe të mos krijohet konfuzion tek operatorët ekonomikë të interesuar për të hartuar ofertat e tyre teknike dhe ekonomike. Vlen të theksohet, se dokumentet e tenderit, nga autoriteti kontraktor, duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mag-Utilites” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Ndriçim Rrugor, (Rikonstruktion)*”, me nr. *REF-88979-03-03-2021*, me fond limit 58,326,574 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën *05.04.2021*, nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë këto ndryshime në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilites” SHPK
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 438 Protokoli, Datë 19.03.2021;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri